

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Have Haliti dhe Abdullah Ahmeti anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z.M. dhe G.M. nga ... R. e Serbisë, për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan dhe përgjigjes në ankesë të prokurorisë nga mbrojtësit e të akuzuarve av. N.N. dhe av. R.L., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore- DKR në Gjilan, PKR.nr.50/2017 të datës 22.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform nenit 390 të KPPK-së, më datën 13.08.2018, mori këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan PKR.nr.50/2017 i datës 22.06.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - DKR në Gjilan PKR.nr.50/2017 i datës 22.06.2018, të akuzuarit Z.M. dhe G.M., janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, meqë nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigjen në ankesën e prokurorisë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Z.M. av. N.N., me propozim që Gjykata e Apelit, ta refuzon ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, si të pabazuar aktgjykimin e ankimuar të e vërtetohet.

Përgjigjen në ankesën e prokurorisë ka paraqitur edhe mbrojtësi i të akuzuarit G.M. av. R.L., me propozim që Gjykata e Apelit, ta refuzon ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, si të pabazuar aktgjykimin e ankimuar të e vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.339/18 të dt. 30.07.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimi, i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit të shpallen fajtor ose çështja të kthehet në rigjykim, ndërsa përgjigjet në ankesën e prokurorisë e parashtruar nga ana e mbrojtësve të akuzuarve, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, nuk mbajti seancën e kolegjit për të cilën nuk u njoftuan Prokurori i Apelit, as të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre , meqenëse të akuzuarit janë liruar nga akuza.

Kolegji, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe përgjigjen në ankesën e mbrojtësve të akuzuarve dhe gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë ThemeloreDKR në Gjilan është e pa bazuar.

Prokuroria pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.2 lidhur me nenin 370 të KPRK-së, dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye të duhura lidhur me faktet relevante që të akuzuarit të lirohen nga akuza, sepse provat të cilat i ka paraqitur prokuroria në aktakuzë janë të mjaftueshme dhe vërtetojnë se me veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar.

Kjo gjykatë duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të prokurorisë, por edhe sipas detyrës zyrtare, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që kishin me ndikuar në anulimin e aktgjykimit. Aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni me dispozitat ligjore, gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar çdo provë veç e veç, e pastaj të gjitha së bashku dhe ka dhënë arsye pse në veprimet e të akuzuarve nuk ekzistojnë elementet e veprës penale e cila iu vihet në barrë sipas aktakuzës

Prokuroria në ankesë pretendon se, me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar, se vepra penale e cila i vihet në barrë të akuzuarve Z.M. dhe G.M., vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit N.N. si dhe provave tjera materiale, fakturave të furnizimit me derivate të naftës, për periudhën gjatë vitit 2013, vërtetohet se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë elementet e veprës penale keqpërdorim pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPPK-së, se ka prova të mjaftueshme mbi të cilat e ka bazuar aktakuzën me të cilat prova është vërtetuar fajësia e të akuzuarve.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga gjykata e shkallës së parë, se pas administrimit të provave materiale, dëgjimit të dëshmitarëve N.N., S.S., L.P., K.R., N.R., si dhe dëshmisë së përfaqësuesit të Komunës nuk është vërtetuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë, se sipas dëshmitari N.N., të gjitha fakturat nuk kanë mund me qenë fictive, por ka mundësi ti jenë fryer fakturat të shkruhet sasi ma e madhe e naftës, kurse nuk e din se të akuzaurit a kanë marrë naft drejt për drejt, kurse dëshmitari L.P. si ish drejtor i financave, K.R. zyrtar i financave në Komunë njejtë kanë deklaruar se fakturat kanë qenë në rregull, komuna është furnizuar me naft dhe për këtë kanë pasur paragon blloku sëbashku me faktura, kurse njejtë ka deklaruar edhe N.R. menagjer i kompanisë “Euro Tafa”, se të gjitha paragonat kanë qenë në rregull se vetëm nëse një gabim ka qenë paragonat i kanë kthyer, se të akuzuarit asnjëri nuk kanë nënshkruar asnjë paragon fiktiv dhe nafta që është marrë për komunën e Klllokotit është marrë vetëm për veturat zyrtare, kurse përfaqësuesi i komunës M.S. më fjalën përfuandimtare ka deklaruar se komuna e Klllokotit nuk është e dëmtuar në këtë rast, se fakturat janë reale dhe nuk janë fikve, sepse derivatet e naftës janë përdorur për nevojat zyrtre të komunës, kurse sa ju përketë paragonave dhe bllokave ato janë asgjësuar, nuk janë arhivu dhe kallximi penal është bërë për hakmarrje personale.

Gjykata e Apelit, gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e aprovon, sepse e njëjta është e bazuar në provat që i ka administruar gjykata e shkallës së parë e që gjinden në shkresat e lëndës, si dëshmime të dëshmitarëve të cekur më lartë, se, nuk është vërtetuar se të akuzuarit Z.M. dhe G.M., kanë lëshuar e fakturave fiktivenë emër të Komunës siç i ngarkon aktakuza, kurse prokuroria në ankesë nuk ka paraqitur prova tjera për veç atyre që gjykata e shkallës së parë i ka vlersuar, ajo vetëm ka bërë përshkrimin e dëshmime të dëshmitarë dhe provave mateiale sikur në akuzë, ashtu që me asnjë provë nuk është vërtetuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 idhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vlerësuar se nuk ka prova të mjaftueshme që e vërtetojnë fajësinë e të akuzuarve dhe në mungesë të provave të njëjtit i ka liruar nga akuza.

Nga e gjithë ajo që u tha më lartë, meqenëse aktgjykimi i ankmiuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e aprovon dhe kjo gjykatë, prandaj gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar ligjin penal kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza, meqenëse me provat e administruara nuk është vërtetuar se e kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Për arsyet e cekura më lartë ankesa e prokurorisë nuk është e bazuar.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK-së.

Procesmbajtësi
Kryetar i kolegjit
Eroll Gashi

Antarët e kolegjit

Fillim Skoro

1. Have Haliti
2. Abdullah Ahmeti